Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

MAPAS

15 SHTATORI
DITA E VETËDIJESIMIT PENSIONAL

BULETINI ELEKTRONIK

E-MAPAS

NR.59

TETOR 2026

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS), në bashkëpunim me Asociacionin e Shoqërive Pensionale, shënoi 15 Shtatorin – Ditën e Vetëdijesimit Pensional. Kjo datë e rëndësishme shënohet që nga viti 2014, me qëllim kryesor që tema e kursimit pensional t'u afrohet qytetarëve dhe të nxitet informimi dhe përgjegjësia më e madhe për planifikimin financiar. Këtë vit, aktiviteti qendror u mbajt në shkollën e mesme ekonomiko-juridike SHMEJQSH „Vasil Antevski Dren" – Shkup, me fokus të veçantë te gjeneratat e reja dhe edukimi i tyre financiar.



Në aktivitetin solemn mbajtën fjalime kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, Remzi Bajrami, kryetari i Asociacionit të Shoqërive Pensionale, Marijan Nikolovski, dhe drejtori i SHMEJQSH „Vasil Antevski Dren", Aleksandar Mijoski. Mesazhi kryesor ishte se për pensionin nuk duhet të mendohet vetëm kur afrohet koha e pensionimit, por që nga paga e parë e fituar. Zakonet financiare dhe përgjegjësia ndaj së ardhmes personale krijohen që në moshë të hershme, prandaj vëmendje e veçantë këtë vit iu kushtua pikërisht nxënësve të shkollave të mesme.

Një nga pjesët kryesore të shënimit të sivjetshëm ishte nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet MAPAS-it dhe SHMEJQSH „Vasil Antevski Dren" – Shkup. Me këtë dokument krijohet një urë e qëndrueshme ndërmjet arsimit dhe praktikës. Qëllimi është t'u mundësohet nxënësve që njohuritë teorike t'i lidhin me përvojat praktike dhe të njihen me punën e institucioneve publike. Memorandumi parasheh realizimin e mësimit praktik, mësimit përmes punës dhe praktikës gjatë pushimeve shkollore, si dhe organizimin e vizitave edukative, prezantimeve dhe punëtorive në fushën e edukimit financiar, sistemit pensional dhe sigurimit pensional të financuar kapitalisht.



MAPAS-i punon vazhdimisht për rritjen e edukimit financiar dhe pensional në shoqëri. Mbështetje të konsiderueshme në realizimin e këtyre aktiviteteve edukative japin edhe shoqëritë pensionale (BK Shoqëria e pare pensionale, Sava Shoqëri pensionale dhe Triglav Shoqëri pensionale). Në botën e sotme, ku ndryshimet janë të shpejta dhe të vazhdueshme dhe ku të rinjtë përballen me profesione dhe teknologji të reja, njohuritë financiare nuk përbëjnë vetëm një shkathtësi shtesë, por një aftësi të domosdoshme jetësore, e cila ndihmon në marrjen e pavarur dhe të përgjegjshme të vendimeve financiare.



Ky aktivitet është një shembull i shkëlqyer se si institucionet, sektori arsimor dhe komuniteti i biznesit mund të bashkëpunojnë për të krijuar vlerë të shtuar për të rinjtë. Mesazhi i MAPAS-it për të gjithë qytetarët, më 15 shtator, është i qartë: INFORMOHUNI, MENDONI ME KOHË DHE PLANIFIKONI TË ARDHMEN TUAJ, SEPSE E ARDHMJA PENSIONALE NDËRTOHET SOT.

„Kush kursen në rini, nuk i frikësohet pleqërisë.“

„Pension i lehtë, mund në rini.“

TREGJET PENSIONALE NË FOKUS – TË DHËNA PARAPRAKE PËR VITIN 2025

Sipas të dhënave më të fundit paraprake të OECD-së, të publikuara në botimin „Tregjet pensionale në fokus – Të dhëna paraprake për vitin 2025“, mjetet pensionale në nivel global vazhduan të shënojnë rritje të konsiderueshme edhe gjatë vitit 2025.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.

INFORMACION PËR SHFRYTËZUESIT AKTUALË QË REALIZOJNË PAGESË TË PENSIONIT NGA SIGURIMI PENSIONAL I DETYRUESHËM ME FINANCIM KAPITAL (SHTYLLA E DYTË PENSIONALE)

Shtylla e dytë pensionale është pjesë e sistemit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe bazohet në llogaritë individuale të të siguruarve, në të cilat grumbullohen dhe investohen mjete për realizimin e të drejtave pensionale. Me maturimin gradual të

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.

30/06/2026

	Број на пензионери	Исплатен нето износ	Просечен нето износ	Просечен стаж	Пензиска основица
ВКУПНО	**147**	**1.452.089 ден.**	**9.878 ден.**	**22**	**38.880 ден.**
СО МИНИМАЛНА ПЕНЗИЈА					
вкупна нето исплата од сметка	**113**	**1,149,023 ден.**	**10,168 ден.**	**21**	**27,003 ден.**
до 4.000 ден.	0	- ден.	- ден.	0	- ден.
4.001 ден.– 8.000 ден.	38	246,890 ден.	6,497 ден.	23	29,660 ден.
над 8.000 ден.	75	902,133 ден.	12,028 ден.	20	25,660 ден.
НАД МИНИМАЛНА ПЕНЗИЈА					
вкупна нето исплата од сметка	**34**	**303,066 ден.**	**8,914 ден.**	**25**	**81,762 ден.**
до нè 4.000 ден.	8	20,814 ден.	2,602 ден.	21	29,188 ден.
4.001 ден.–8.000 ден.	14	76,090 ден.	5,435 ден.	24	43,970 ден.
над 8.000 ден.	12	206,162 ден.	17,180 ден.	28	166,607 ден.
над 16.000 ден.	7	155,744 ден.	22,249 ден.	29	202,137 ден.
над максимална	5	122,519 ден.	24,504 ден.	34	228,422 ден.

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL – MAPAS MORI PJESË NË BRIFINGUN PËR MEDIE TË ASOCIACIONIT TË SHOQËRIVE PËR MENAXHIM ME FONDET PENSIONALE (ADPF)

Përfaqësuesit e MAPAS, Kryetari i Këshillit të Ekspertëve, Remzi Bajrami dhe anëtarja e Këshillit të Ekspertëve, Pranvera Suma, morën pjesë në brifingun me gazetarë të organizuar nga ADPF.

Në këtë takim pune u diskutua mbi stabilitetin, sfidat dhe perspektivat e zhvillimit të sistemit pensional me financim kapital në vendin tonë.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.

U MBAJT TAKIM PUNE ME MINISTRIN POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE RINISË, GJOKO VELKOVSKI

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, Remzi Bajrami, anëtari i Këshillit të Ekspertëve, Pranvera Suma dhe këshilltarja kryesore e kryetarit të MAPAS-it, Marija Popovska, zhvilluan një takim pune me Ministrin e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, Gjoko Velkovski.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.



ËSHTË DORËZUAR KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË – MENAXHIMI I FONDEVE TË DETYRUESHME PENSIONALE

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional– MAPAS njofton se nga ana e SHMDPF VFP Shoqëri Pensionale SHA Shkup, është dorëzuar kërkesë për marrjen e lejes për kryerjen e veprimtarisë – menaxhimi i fondeve të detyrueshme pensionale, miratimit të kushtëzuar për menaxhimin e fondit të detyrueshëm pensional dhe regjistrimin e fondit të detyrueshëm pensional në Regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale.

Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.

PËRFAQËSUES TË MAPAS-IT NË KONFERENCËN E 25-TË VJETORE TË BURSËS SË MAQEDONISË

Kryetari i Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimit Pensional me Financim Kapital – MAPAS, Remzi Bajrami, anëtarja e Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, Pranvera Suma, Këshilltarja kryesore e kryetarit të MAPAS-it, Marija Popovska, dhe Udhëheqësi i Njësisë për Kontroll Institucional, Festim Beqiri, morën pjesë në Konferencën e 25-të vjetore të Bursës së Maqedonisë, e cila u mbajt më 22 dhe 23 shtator 2026 në Ohër.



Për më shumë informacione vizitoni ***linkun*** e mëposhtëm.

KENI PYETJE OSE ANKESA?
Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në contact@mapas.mk

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Тел: (02) 3224 229
www.mapas.mk

МКД СЕРТИФИКАТ
МКС EN ISO 9001:2015

TÜV NORD
TÜV NORD CERT GmbH
ISO/IEC 27001